

Standardi puro Serb me titull ***“Rregullorja mbi cilësinë e mishit, mishit gjysmë të gatshëm dhe produkteve të tjera të mishit”***.

Ky standard 47 faqësh, përcakton kushtet lidhur me cilësinë e mishit të grirë; përgatitjen e mishit dhe produkteve të tij, që lidhen me klasifikimin, kategorizimin dhe emrin e produktit; kontrollet fizike, kimike, fiziko-kimike, si dhe përbërjen e produkteve; metodat për të testuar cilësinë; procedurat teknologjike të aplikuara në prodhim; paketimin dhe etiketimin e produkteve.

Në objektiv është harmonizimi me dispozitat e Rregullores mbi Etiketimin, Prezantimin dhe Reklamimin e Produkteve Ushqimore dhe me amendamentet mbi Rregulloren (EC) nr. 853/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 29 prill 2004, e cila përcakton rregullat specifike të higjienës për produktet ushqimore.

Afati i fundit për marrjen e komenteve është ***15/05/2019***.

Ky njoftim realizohet në kuadër të njoftimit të operatorëve ekonomikë që mund të kenë interesa tregtare me shtetin serb lidhur me këtë kategori produktesh, të cilët mund të paraqesin komentet e tyre. Komentet potenciale adresohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, e cila me ligj është pika e kontaktit për sa i përket shkëmbimit të informacionit mbi standardet dhe rregullat teknike.